



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
SHOQËRIA AKSIONARE UJËSJELLËS KANALIZIME BERAT-KUÇOVË  
ASAMBLEJA E PËRGJITHËSHME E SHOQËRISË

Nr. 03 Prot.

Berat më, 25/04/2023

VENDIM  
NR. 02 DATË 25/04/2023  
PËR

**PËRFUNDIMIN E AKTIVITETIT TË SHOQËRISË ,SHPALLJEN E SAJ NË  
LIKUIDIM DHE EMERIMIN E LIKUIDATORIT**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, sot, më datë 25 Prill 2023, Shoqëria Aksionare Ujësjiellës Kanalizime Berat-Kuçovë, një shoqëri e themeluar sipas ligjit shqiptar, me kodin unik NIPT J62903166T, mbajti mbledhjen e Asamblesë. Mbledhja u thirr nga administratori i shoqërisë zoti Polizoj Ikonomi, për të diskutuar mbi rendin e ditës si vijon:

**Çështjet e rendit të ditës:**

- Prishja e shoqërisë dhe shpallja e saj në likuidim;
- Emërimi i Likuidatorit.

**Në shqyrtim të rendit të ditës, Asambleja vëren:**

Shoqëria Aksionare Ujësjiellës Kanalizime Berat-Kuçovë nuk zhvillon më aktivitete pasi në përputhje me VKM Nr. 302, datë 11.05.2022 si dhe me marrëveshjen noteriale Nr.4797 Rep. dhe Nr. 2732 Kol, datë 15.11.2022 midis shoqërisë Aksionare Ujësjiellës Kanalizime Berat-Kuçovë dhe shoqërisë Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Berat sha, kjo shoqëri e ka transferuar veprimtarinë ekonomike si dhe aktivet dhe detyrimet e saj në tërësi. Nga data 1.1.2023, kjo shoqëri nuk ka më të drejtë të zhvillojë aktivitetin për të cilin ajo është themeluar.

Për sa konstatohet më sipër, shoqëria e ka përmbushur qëllimin e krijimit dhe nuk ka më arsye të vijoje ekzistencën e saj dhe duhet të prishet dhe të cregjistrohet nga regjistri tregtar QKB.

**Pasi diskutoi gjerësisht mbi rendin e ditës, Asambleja**

**VENDOSI:**

1. Përfundimin e aktivitetit të shoqërisë Aksionare Ujësjiellës Kanalizime Berat-Kuçovë dhe prishjen e saj
2. Shoqëria Aksionare Ujësjiellës Kanalizime Berat-Kuçovë shpall hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese;
3. Emërimin e Z. Polizoj Ikonomi si likuidator të shoqërisë Aksionare Ujësjiellës Kanalizime Berat-Kuçovë.

4. Likuidatori është i autorizuar të përgatisë Raportin Përfundimtar të likuidimit të shoqërisë. Ai është gjithashtu i autorizuar të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm për likuidimin e shoqërisë si dhe të kërkojë, paraqesë çdo dokument të nevojshëm pranë autoriteteve private dhe publike në lidhje me likuidimin e shoqërisë.


Ky vendim hynë menjëherë në fuqi,

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHMË E AKSIONARËVE

Për Bashkin Berat

KRYETARI

Ervin DEMO



Për Bashkin Kucovë

KRYETARI

Kreshnik HAJDARI

